

LIGJ

Nr.10 220, datë 4.2.2010

PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT PËR MJETET MOTORIKE LUNDRUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pezullohen të gjitha lëvizjet e mjeteve motorike lundruese shqiptare në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga funksioni i përdorimit të mjetit, si dhe transporti i mjeteve lundruese në rrugë tokësore, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji.

Pezullimi përfshin edhe mjetet motorike të lundrimit turistik dhe të sporteve ujore.

Neni 2

Afati i zbatimit të këtij ligji është 3 vjet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 3

Përjashtohen nga ky moratorium:

- a) mjetet motorike lundruese në përdorim të organeve shtetërore dhe të shërbimeve portuale;
- b) mjetet lundruese të destinuara vetëm për peshkim, sipas ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar;
- c) mjetet e transportit detar, që shërbejnë për transportin e mallrave;
- ç) mjetet e transportit detar, të licencuara për transport pasagjerësh dhe të klasifikuara nga Regjistri Detar Shqiptar si mjete lundruese për transport udhëtarësh;
- d) motorët e ujit.

Neni 4

Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën 800 000 - 1 000 000 lekë dhe me konfiskim të mjetit.

Vendimi për masën administrative merret nga shefi i komisariatit të juridiksionit të konstatimit të shkeljes.

Kundër këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga marrja dijeni, bëhet ankim te drejtori i policisë së qarkut.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1 e 3 të tij.

Neni 6

Ngarkohen Policia e Shtetit dhe Roja Bregdetare për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6432, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi